



Npi – 01/92 datë: 29.04.2022

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Në bazë të neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe në bazë të Kërkesës të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal Nr.04-416 të datës 05.04.2022, për rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për vitin 2022, Npi-01-70. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më datën: 29.04.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2022, Npi – 01/70 të datës: 07.04.2022

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 29.04.2022, unanimitisht miratoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022, Npi – 01/70 datë: 07.04.2022, si vijon:

1. Neni 13 i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2022, Npi – 01/70, ndryshohet sipas rekomandimit të MAPL-së dhe bëhet si vijon: *"Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë për personat fizik, ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për kundërvajtjet, respektivisht nenit 29 (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtjet".*

II

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Rregullorja u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi